



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	28.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINYSHCK	5733/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.688/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.688/2022 të datës 04.08.2022, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.688/2022 e datës 04.08.2022 e parashtruar nga ankuesja ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* tek Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, më datë 04.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se është duke iu mohuar e drejta

elementare në karrierë për shkak të mos nxjerrjes së vendimit nga Komisioni për Grada dhe Disipline i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me kërkesën e saj për gradim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 14.09.2022, ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë 15.09.2022 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka dërguara përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datën 15.09.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.95/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati vendimmarrës ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2119/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 07.03.2022, për qasje në dokumente zyrtare; Vendimi i datës 15.03.2022, i z, v Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës e- maili i datës 17.03.2022; E- maili i datës 31.03.2022, drejtuar anëtarëve të Komisionit për Gradim; Kërkesë e datës 07.09.2022, drejtuar Komisionit për Grada dhe Disiplinë; Vendimi i datës 10.09.2018, i Zëvendëskryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 30.12.2015, i Zëvendëskryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Formuari për Vlerësimin e nëpunësit për Shërbime të Jashtme; i vitit 2020; Vërtetim i datës 06.09.2021; Vendimi i datës 22.07.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 23.09.2019, për caktimin e ushtrueses së detyrës; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit të datës 10.06.2013; Akt Emërimi i datës 20.07.2012; Vendimi i datës 15.03.2022, i Z v Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vërtetim i datës 06.09.2021 i Udhëheqësit të Divizionit të Personelit; Përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022, me numër protokolli 2533/2022; Vendimin e Këshillit A.nr.378/2022 të datës 30.05.2022; Ankesën e datës 04.08.2022 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 4528/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.09.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 15.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Kërkesën për qasje në dokumente zyrtare e datës 29.06.2022; Procesverbalin e datës 13.06.2022 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të MPJD-së; Vendimin e datës 06.07.2022 me numër: 224/2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të MPJD-së; E-mailin e detyrës 15.09.2022 dërguar nga V.B për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur; Vërtetimin e datës 06.09.2021; vendimin e Kryetarit të këshillit e datës 15.09.2022; Vendimin e datës 10.05.2022 të DMZP/MPB; Akt emërimit e ankueses të datës 13.06.2022; Vendimin e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së i datës 01.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 13.06.2022 me shifër AE.Nr.07/2022 është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë e Personelit" në kuadër të Njësisë së Burimeve Njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e administruara të lëndës, ka konstatuar se ankuesja me datë 14.04.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshill kundër institucionit punëdhënës, gjegjësisht Komisionit për Grada dhe Disiplinë pasi që të njëjtët nuk e

kishin trajtuar kërkesën e ankueses të datës 07.09.2021 për gradimin e së njëjtës apo avancimin në gradë në kuadër të Shërbimit të Jashtëm Diplomatik, ndërsa Këshilli me datë 30.05.2022 përmes Vendimit A.nr.378/2022 e kishte detyruar Komisionin për Grada dhe Disiplinë që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankueses dhe në pajtim me kompetencat që ka, të vendos me akt administrativ, duke e pranuar apo refuzuar të njëjtën kërkesë, mirëpo Komisioni për Grada dhe Disiplinë me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit kishte organizuar mbledhjen e datës 13.06.2022 dhe në bazë të procesverbalit, anëtarët e komisionit kanë mbetur pranë qëndrimit të njëjtë sikurse në mbledhjen e datës 08.12.2022 duke mos nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankueses.

Po ashtu, për Kolegjin e Këshillit mbetet e paqarte dhe e pakuptueshme se si Komisionin për Grada dhe Disiplinë në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2022 sipas procesverbalit konfirmohet se në takim kanë qenë prezentë vetëm katër (4) anëtarë, ndërsa të njëjtit kanë mbetur prapa qëndrimit sikurse në mbledhjen paraprake të Komisionit bazuar në procesverbalin e datës 08.12.2021 ku prezent kanë qenë gjashtë (6) anëtarë, ku dy (2) prej tyre kanë votuar pro, ndërsa katër (4) kanë abstenuar, nga rrjedh se logjikisht është e pamundur që katër (4) anëtarë të mbeten prapa qëndrimit të njëjtë apo ta ri konfirmojnë qëndrimin për mbledhjen dhe pikën e rendit të ditës të votuar kohë më parë kur asaj kohe kanë qenë prezent dhe kanë votuar gjashtë (6) anëtarë të Komisionit ku madje edhe përbërja mund të ketë qenë tjetër, apo thënë më thjeshtë katër (4) anëtarë të komisionit nuk mundën të votojnë në emër të gjashtë (6) anëtarëve të komisionit në rastin konkret sikurse kanë vepruar në mbledhjen e Komisionit për Grada dhe Disiplinë bazuar në procesverbalin e datës 13.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Organi publik kolegjal (në vijim: organi kolegjal) është një grup personash, të caktuar sipas ligjit, që përfshihen në një procedurë administrative me kompetenca vendimmarrëse apo këshillimore”,* si dhe nenit 2 të Ligjit nr. 03/1-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës”- është komisioni i ngarkuar me dhënien, përveç gradës ambasador, të gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm, si dhe propozimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve të shërbimit të jashtëm dhe shqyrtimin e ankesave për masat disiplinore të marra ndaj tyre”,* konstaton se Komisioni për Grada dhe Disiplinë në rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 07.09.2021 është i obliguar që të nxjerr akt administrativ siç përcaktohet me nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe:”* si dhe i njëjti akt duhet të përmbaj elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar siç përcaktohet me nenin 47 i të njëjtit ligj.

Po ashtu referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 ku përcaktohet se: *“Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose 1.3 zbaton kompetencat e veta përmes akteve reale, që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave”* dhe përderisa aktet e brendshme që rregullojnë dhe përcaktojnë kompetencat e Komisionit për Grada dhe Disiplinë nuk kanë dispozita të aplikuara që përcaktojnë apo rregullojnë ndryshe vendimmarrjen e organeve kolegjiale, dhe mbi këtë bazë

Kolegji i Këshillit konstaton se obligimeve për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, gjegjësisht Komisioni për Grada dhe Disiplinë me rastin e trajtimit të kërkesës së ankueses për avancim apo dhënie të gradës e ka obligim ligjor nxjerrjen e aktit administrativ, pavarësisht natyrës vendimmarrëse, ngase ky obligim rrjedh nga dispozitat e nenit 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në mbështetje edhe të të nenit 37 paragrafit 1 i të njëjtit ligj.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkret e lëndës ka gjetur se ankuesja nuk është njoftuar lidhur me natyrën e trajtimit kërkesës së saj të cilën Këshilli e kishte kthyer në detyrim përmes vendimit A.nr.378/2022 të datës 30.05.2022 tek Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo të njëjtës me datë 29.06.2022 iu është dashur të bëjë kërkesës për qasje në dokumentet zyrtare me qëllim që të njoftohet me natyrën e trajtimit të kërkesës së saj sipas procesverbalit të datës 13.06.2022 ngase nuk është artikulluar shprehimisht qëndrimi i anëtarëve të Komisionit, gjegjësisht nuk është nxjerr akti administrativ dhe as nuk është njoftuar pala ankuese, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se institucioni punëdhënës dhe Komisioni përgjegjës kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës"*.

Kolegji i Këshillit meqenëse ka gjetur dhe konstatuar shkelje të natyrës procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor për Grada dhe Disiplinë lidhur me trajtimin e kërkesës së ankueses të datës 07.09.2021 lidhur me avancimin apo gradimin e saj në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik, ankesën e ankueses e ka aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, vetëm për shkak të mungesës së nxjerrjes së aktit administrativ dhe njoftimit me natyrën vendimmarrëse, ndërsa lënda e ankueses është kthyer për herën e fundit në ri-shqyrtim me qëllim të eliminimit të këtyre shkeljeve por pa predikuar natyrën vendimmarrëse nga ana e Komisionit për Grada dhe Disiplinë.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të ankueses si dhe pas konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, Komisioni për Grada dhe Disiplinë gjatë rishqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 07.09.2021, dhe në rast të mos evitimit të shkeljeve procedurale të evidentuara në këtë vendimi, përbën shkak për shkelje ligjore procedurale dhe mbi bazën e kompetencave që ka Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil do të veprojë konform mandatit të përcaktuar me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku organit apo drejtuesit të organit tek i cili bie barra e zbatimit të këtij vendimi do tu ndalen 50% të pagës deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 688/2022

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

